



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 DHJETOR 2015 (ora 22:00)

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. DECEMBRA 2015. GODINE (22:00 sati)

DHJETOR - DECEMBAR
2015

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-034 o Kosovskoj agenciji za privatizaciju, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-115.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Atëherë, të nderuar deputetë, edhe kështu ka kaluar nata e vonshme. Po e përfundojmë një pikë të rendit të ditës, dhe për pikën tjetër pastaj do të kemi diskutim, por me rëndësi është që të përfundojmë punën brenda kornizës ligjore që i kemi edhe kushtetuese.

Kjo është seancë e re plenare.

Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 71 deputetë, prandaj mund të fillojmë punën e seancës plenare.

Ju njoftoj se në pajtim me propozimin e vendimit të Kuvendit të datës 14 dhjetor 2015, procedojmë me rendin e ditës për seancën e sotme.

E kemi një pikë të rendit të ditës dhe po fillojmë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Komisioni parlamentar, në bazë të vendimit të seancës plenare, më 14 dhjetor 2015 e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Muhamet Mustafa, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti kryetar i Kuvendit,
Ne po presim tekstin e spastruar të amendamenteve. Ju lutem, duhet të jetë teksti këtu, sepse deputetët duhet ta kenë tekstin. Ose, le të ma sjellin origjinalin dhe po e lexoj unë.

KRYETARI: Atëherë, në rrethana që jemi duke punuar, është kohë e shkurtër, por Administrata aq sa po mund po e kryen punën e vet.

MUHAMET MUSTAFA: Atëherë, në ndërkohë besoj Administrata do ta shpërndajë.
Ju faleminderit!

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i ka proceduar amendamentet në Projektligjin nr. 05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në bazë të Rregullores, ne kemi bërë një lexim të dytë të kujdesshëm dhe kemi propozuar amendamentet, si vijon:

Amendamenti 1.

Neni 12 i Ligjit bazik riformulohet si vijon. Pra, është neni 12 - Përbërja e bordit.

“Bordi përbëhet nga 8 drejtorë. Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë, emëron drejtorët e Bordit, duke përfshirë 1 përfaqësues nga komunitetet joshumicë dhe 1 përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve.

Pika 2. Kuvendi me propozimin e Qeverisë nga radhët e anëtarëve të Bordit e cakton kryesuesin e Bordit.

4. Bordi e emëron zëvendëskryesues të Bordit njërin nga anëtarët e tij.

1. Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet drejtor, nëse:

- pika 5.1, është dënuar për ndonjë veprë penale.

- pika 5.2. është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëturjeshtëm i profesionit të tij për shkak të shkeljeve të rënda profesionale në pajtim me legjislacionin në fuqi;

- 5.3. Nëse ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo në kuadër të një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim, dhe

1.4. Ka interesa ose angazhohet në veprimtaritë të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15 të këtij ligji.

Pika 6. Për të pasur të drejtën e zgjedhjes drejtor, personi duhet të ketë së paku 5 vite përvojë në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa dhe punë menaxheriale, dhe këtu i shtohet “ose profesionale”.

Pra, “menaxheriale ose profesionale”.

Ju lutem, të ka ra në tekst, nuk është shtypur. Është “menaxheriale ose profesionale”.

7. Bordi emëron drejtorin e sekretarisë ekzekutive të Bordit i cili nuk mund të jetë anëtar i Bordit për emërim, shkarkim ose ndryshim në kushte të referimit të drejtorit të sekretarisë ekzekutive të Bordit, kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit.

8. Drejtori menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorët menaxhues nuk janë anëtarë të Bordit.

Amendamenti 2.

Neni 3, riformulohet si vijon:

“Neni 14 i paragrafit 4 të Ligjit bazik, riformulohet si vijon: Bordi ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku 5 drejtorë”.

Neni 14, paragrafi 7 të Ligjit bazik, riformulohet si vijon: Për vendimet të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15 nevojitet shumica e kualifikuar.

Vendimi do të merret së paku me 5 vota për, dhe

3.Neni 14 paragrafi 9 i ligjit bazik, fshihet.

Amendamenti 3.

Neni 4, riformulohet si vijon:

Neni 15, nënparagrafi 2/3 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

“2.3 emërimi apo shkarkimi i drejtorit menaxhues dhe zëvendës drejtorit menaxhues ose të ndonjë zyrtari tjetër”.

Amendamenti 4.

Neni 5 riformulohet si vijon: Neni 31 paragrafi 5 i Ligjit bazik fshihet.

Dhe, amendamenti i fundit 5. Këto ndryshime dhe plotësime të Ligjit hyjnë në fuqi ditën e publikimit në “Gazetën zyrtare” të Kosovës.

Kjo nuk është e shënuar por duhet të jetë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, kryetari i Komisionit FunkSIONAL i lexoi në përpikëri amendamentet.

A ka paqartësi, sepse Administrata s’ka arritur ende edhe në gjuhët tjera? A mund të procedojmë? Atëherë, në rregull!

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 4 amendamente.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional.

Po shkojmë me 1, 2, 3, 4, të gjitha bashkë, nëse s’keni kundër!

A është kush kundër?

Abstenim?

Atëherë, aprovohen të gjitha.

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Me ngritje dore, lus deputetët të deklarojnë.

72 deputetë janë të pranishëm.

Kush është për?
Kush është kundër?
Abstenim?

Atëherë, me 70 vota për dhe 2 kundër, Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Tani, kërkoj vëmendje! Është një pikë e rendit të ditës dhe unë do t'i shpreh qëndrimet që kanë të bëjnë me Rregulloren. E patë edhe më herët, kur e filluam debatin juristët në mes veti, të na qartësojnë ne deputetëve para votimit.

Jemi në pikën e fundit të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Në rend të parë, ta kemi parasysh. Ne kemi aktualisht 8 anëtarë të Bordit dhe do të shkojmë me një kronologji. Vendimmarrjen e keni ju. Unë nëse ju e keni vendimmarrjen, publikisht e them se kam me i nënshkruar dhe thjesht, pa marrë parasysh a është gabim a s'është, por është një situatë në të cilën ne jemi vonuar, edhe pse me 16 dhjetor 2014 kemi shkruar shkresë për plotësimin e emërimit të 5 anëtarëve të Bordit dhe nuk ka ardhur, na ka ardhur me 1 dhjetor 2015 edhe me ndryshua ligjin dhe bordin.

Propozimi që vendimi për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të hyjë në fuqi pas hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk mund t'i referohet një ligji pa hy në fuqi.

Ne jemi duke i votuar tash 8 anëtarë të Bordit me ligjin e ri, të cilin e aprovuam. Por, ky ligj nuk hyn në fuqi pa u nënshkrua nga presidentja.

Tani çështja kontestuese është kështu. Ne kemi mundësi, kur nuk mund të frikësohemi fare nga një reagim, t'i votojmë 5 anëtarë të Bordit me çka edhe e kryejmë punën, dhe ka kuorum Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Në qoftë se shkojmë t'i votojmë 8 është si të ndërtohet shtëpi pa pas tokë. Ne mund të marrim këtë vendim, por precedent nuk paska pasur në Kuvend, këtë ta kemi parasysh dhe është precedent i parë të cilin ju me vetëdije në qoftë se e votoni edhe unë me emër të zotit do ta nënshkruajë. Këtë ta keni parasysh! Pavarësisht se kam vërejtje ngase nuk ka bazë juridike me bë nga juristët, thjeshtë, por le të marrin përgjegjësi. Ja ku jemi, urdhëroni kush e do fjalën? Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

E para, duhet të bëjmë një sqarim se pse është 5 plus 3. Pse janë 8, do të thotë, dhe pse po kërkohet ajo që është ndryshuar me ligjin e ri, që u votua sot.

3 anëtarë që janë bërë 8, kanë qenë ndërkombëtarë deri në vitin 2014, të cilëve u është përfunduar mandati dhe në përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur i takon që tash të jenë përfaqësues vendor. Dhe ky është sqarimi i ndryshimit të numrit.

E dyta. Ne nuk po ndërtojmë precedent sepse kemi legjislacion të cilën hyrjen në fuqi e kemi pas 1 viti ose pas 2 viti të disa çështje të caktuara. Për shembull, kemi shumë ligje të cilat ne i kemi miratuar në Kuvendin e Kosovës por hyrjen në fuqi dhe zbatimin e saj e kemi në vitin 1 janar 2016 ose në vitin 2017. E para.

Dhe e dyta. Nëse ai propozim i Qeverisë vjen sot, ai duhet ta ketë një propozim shtesë që mandati i të zgjedhurve fillon nga hyrja në fuqi e ligjit të cilin e votuam pak më parë. Kuptohet, të ligjit të ri.

KRYETARI: Edhe një herë, Armend, pa u larguar, të lutem, vetëm një qartësim. Do të thotë propozimi ishte... Është me rëndësi për të gjithë deputetët kur votojnë. Pra, edhe një herë, specifikojë atë që e the.

ARMEND ZEMAJ: Unë s'po mund ta specifikoj pa ardhur propozimi prej Qeverie, por në momentin që vjen ai propozim sipas ligjit të ri, mandati i këtyre të përzgjedhurve, nuk po paragjykoj, nëse e marrin votën e Kuvendit duhet të fillojë nga dita e hyrjes në fuqi, i cili u votua pak më parë.

KRYETARI: Arben, a e do fjalën? Urdhëro! E patëm një interpretim serioz të Armendit, e tash edhe Arbeni e do fjalën.

ARBEN GASHI: Vetëm për referencë! Ministri i Drejtësisë është këtu. Nëse nuk gabo, kur kemi aprovuar Ligjin për Agjencinë për mbrojtjen e dëshmitarëve, kemi thënë që ligji hyn në fuqi pas një viti e gjysmë, më duket. Ndërkohë, që Agjencinë e kemi themeluar dhe ka qenë kompetencë e bashkëdyzuar me UNMIK-un dhe EULEX-in mbrojtja e dëshmitarëve dhe ka qenë proces shumë specifik.

Prandaj, në këtë rast ka plot ligje për të cilat ne kemi vendos që pas një periudhe të caktuar hyjnë në fuqi. Ky nuk është ligj që tash e aprovojmë, është vendim i Kuvendit për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ligji është aprovuar, dhe sapo aprovuar dhe tash Kuvendi mund të vendosë që vendimi të hyjë në fuqi në periudhën e caktuar në të ardhmen, jo pa hy ligji në fuqi. Cili është rreziku? Rreziku potencial është që nëse dikush e konteston ligjin dhe Gjykata Kushtetuese merr masën e përkohshme të pezullimit të ligjit, për pasojë pezullohet edhe vendimi i Kuvendit për hyrjen në fuqi për formimin e Bordit të AKP-së.

Ky është rreziku i vetëm. Rreziqe tjera nuk ka. Kuvendi mund të marrë këtë vendim, për mendimin tim, dhe krijohet si precedent por ka edhe precedentë analogë, jo të ngjashëm 100%, por me analogji mund të përdoret rasti i Agjencisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i Drejtësisë, nëse ka mundësi, të na interpretojë dhe mos të bëjmë gabime, e pastaj të kthehemi në pikën zero.

Unë e kam një insistim i cili nuk është politik, është apolitik se mund të bëjmë gabime nëse votohen 8 anëtarë të Bordit. E keni parasysh, është gabim në qoftë se i votojmë 8 anëtarë të Bordit ditën e shtatë. 5 mund t'i votojmë.

Urdhëro, Hajdar!

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit kryetar!

I nderuar kryeministër, të nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë në këtë rast, si jurist, mendoj që propozimi i Qeverisë duhet të jetë pasi të hyjë ligji në fuqi dhe pasi ta publikojmë në Gazetë Zyrtare.

Ne e dimë që ky Bord është mediate të jetë i aprovuar ndoshta edhe më herët, që është dashur për bordin e AKP-së. Edhe si deputet kam propozuar edhe më herët që të jetë i komplikuar por nuk shoh praktikë ligjore që të bëhet një propozim me ligj pa qenë ligji.

Unë flas tash si jurist. Praktikë ligjore, konsideroj që ligji duhet të hyjë në fuqi pasi të publikohet në gazetë zyrtare dhe normal që të nënshkruhet prej presidentes, e pastaj Qeveria duhet ta bëjë propozimin e ri, sepse propozimi është me ligj të ri 8 anëtarë, kurse ligji i vjetër i ka 5 anëtarë.

Unë mendoj që propozimi duhet të përsëritet nga Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Ne s'kemi kurrfarë propozimi, pos atij të vjetrit që e kemi. Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Tash po shihet qartë se po ka pak dilema, por nuk duhet të ketë dilema sepse Kuvendi s'është kah e fillon punën sot. E para, ligji hyn në fuqi edhe pa e nënshkruar presidentja, por ajo e ka afatin kohor kur duhet nënshkruar një ligj e nëse nuk nënshkruan automatikisht, e nëse e kthen është çështje e drejtë ekskluzive kompetencë e institucionit të presidentit të vendit.

Unë edhe një herë po e potencoj dhe sigurisht nëse ka dikush opinion tjetër, normal debatojmë.

Mandati i tyre fillon në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit Numër 05/L-088 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ne nuk paragjykojmë rregulla tjera ligjore, nuk po paragjykojmë vendime tjera institucionale por kurdo që hyn në ligji në fuqi edhe ata e fillojnë mandatin e tyre. Nëse është vullneti i juaj sot është vetëm ta aprovoni bordin e 8 anëtarëve.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Ne tash jemi në një situatë deri diku të paqartësisë juridike.

Unë mund të ju them se kur ne e kemi propozuar si Qeveri Bordin, zyra jonë ka qenë e bindur se ne kemi të drejtë t'i propozojmë 8 vetë, sepse me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit që është bërë më parë mandati i ndërkombëtarëve ka kapërcyer me 31 gusht të vitit 2014, prandaj ne kemi konsideruar se 8-shja mbetet dhe ajo 8-she duhet të jetë vendorë, duke respektuar 1 të sindikatës, 1 të komunitetit jo shumicë dhe pastaj 6 shqiptarë.

Unë prapë e kam thirr zyrën time dhe prapë zyra, do të thotë, ka pohuar me argumente se këtu nuk bëhet asnjë gabim që ne i zgjedhim 8 dhe se ata mund të marrin vendime, në të vërtetë mund t'i marrin disa vendime, por jo të gjitha, për shembull vendimet lidhur me ndarjen e 20% nuk mund të merret sepse është vendim në bazë të votës së merituar dhe vendimi lidhur me privatizimin në mjediset shumetnike po ashtu nuk do të ndërmerren deri sa mos të hyjë në fuqi ligji i ri, ndërkaq vendimet e tjera mund t'i marrim.

Tash unë nuk kam kompetencë si kryeministër për të shkurtuar listën që Qeveria e ka propozuar e me thënë prej këtyre po i bëj 5. Mirëpo e kemi edhe problemin tjetër që nesër Bordi duhet të marrë vendime në AKP lidhur me pjesën nga likuidimi, në mënyrë që ne t'i marrim 33 milionë prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, sepse në mbledhjen e ardhshme në Fondin Monetar Ndërkombëtar vendoset që të na jepen 33 milionë e që janë të lidhura me mjetet që i kemi në AKP. Në qoftë se ne nuk mund të marrim vendime të tilla, ne i humbim 33 milionë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe po ashtu s'mund të vendosim për këtë pjesë.

Prandaj, në qoftë se jeni të bindur se ky Bord nuk mund të marrë vendime të tilla, unë kërkoj nga gjysmë ore ta mbaj Qeverinë në mënyrë që Qeveria të vendosë pastaj në qoftë se duhet shkurtuar listën në 5, ta shkurtujmë listën, por unë jam i bindur, në të vërtetë zyra ime ligjore është e bindur se ne mund t'i zgjedhim 8 dhe të 8-tit mund të marrin vendime meritore.

Prandaj, do të jepen shpjegime këtu dhe në qoftë se është e domosdoshme ne nesër edhe e lusim presidenten që ta nënshkruajë këtë ligj për arsye të situatës që e kemi.

KRYETARI: Faleminderit kryeministër! Para se të bëjmë pauzën gjysmë ore, megjithëse e bëmë një pauzë, ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, do të ishte mirë për një qartësim juridik, pasi je edhe pjesëtar i Qeverisë. Prandaj, ministër do të dëgjojmë për një interpretim juridik!

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Unë s'jam autoritet për të interpretuar të drejtën, por do të jap mendimin tim. E tash po flas, jo si anëtar i Qeverisë, por si jurist.

Për të mos pasur asnjë dilemë juridike, është 5 vetë me i emëruar dhe ata të 5 që nga nesër i kanë të gjitha kompetencat të marrin vendime.

Këta 3 tjerë, asnjë vendim s'mund të marrin, pa hyrë në fuqi ky ligj.

Ligji që është miratuar sonte, nuk është në fuqi deri sa të shpallet në "Gazetën zyrtare", ta nënshkruajë presidentja dhe shpallet në "Gazetën zyrtare".

Pra ka dilema juridike, ose për 8 me shty, por këta nuk mund t'i bëjnë 3 e 5 ashtu, me marrë vendime të ndryshme që nga nesër.

Për të qenë të qartë, 5 janë që sonte për t'i votuar, nesër në orën 8:00 kur t'i nënshkruajë kryetari i Kuvendit mund të shkojnë në zyre. Faleminderit!

KRYETARI: E falënderoj ministrin! Dëgjo, se nuk desha të hyj, do të bëj një sqarim.

3 ndërkombëtarëve iu ka kaluar mandati, dhe do të jenë kosovarë. Me 5 anëtarë të Bordit, të cilët janë, mund të merret çdo vendimmarrje, nuk ka humb asnjë euro. Dhe ne po bëjmë gabim, me vetëdije, se po shkojmë me 8 për hir me e tejkaluar një situatë dhe unë jo rastësisht përmenda se që një vit kemi mund ta kryejmë, që 8, që 9 muaj, që 7 muaj.

Pra, po shkojmë me 5, jemi të sigurt dhe s'bëjmë as gabim, e as s'kemi reagime. Dhe deri sa unë po flas në këtë moment, ka reagime.

Unë jam i bindur se nuk do të mund të kalojë 8-shi, edhe në qoftë se e voton ky Kuvend.

Praj, jam shumë i bindur se Qeveria do të kërkojë t'i tërheqë 3 pastaj, sepse kjo ishte edhe arsyeja që u mundova ta sqaroj.

Pra, do të kemi një pauzë prej 25 minuta dhe e vazhdojmë mbledhjen tutje sonte!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, po rikthehemi prapë për të vazhduar.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 1.12.2015, pas shqyrtimit të listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të propozuar nga Qeveria numër 06-56, datë 30 tetor 2015 - referenca 345/2015, datë 16 nëntor 2015, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të emërohen 8 të propozuarit e Qeverisë për anëtarë të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit si në vijim, dhe arsyetimin e paraqet kryetari i Komisionit profesor Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër dhe kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,
Më lejoni që në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik,Infrastrukturë, Tregti dhe Industri t'ju paraqes raportin si vijon:

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i ka propozuar Kuvendit 8 kandidatë për anëtarë të Bordit të Agjencisë së Privatizimit, si vijon:

- Petrit Gashi, kryesues,
- Hasime Mazreiku, anëtare,
- Hamdi Jaha, anëtar,
- Skender Komoni, anëtar,
- Ismajl Jonuzi, anëtar,
- Haxhi Arifi, anëtar,
- Ranko Gjokiq, anëtar, dhe
- Bajram Zejnullahu, anëtar.

Komisioni, pas shqyrtimit të listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit të Agjencisë së Privatizimit, të propozuar nga Qeveria, ka konstatuar se kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit si dhe me plotësimet e këtij ligji, që i bëmë sot.

Të gjithë kandidatët kanë ekspertizën dhe përvojën e nevojshme për t'i kryer detyrat me përgjegjësinë e tyre, prandaj i propozon Kuvendit, që listën e kandidatëve të propozuar nga Qeveria, ta aprovojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, e kemi një propozim, të cilin e konsumuam edhe më herët dhe s'kam më tepër çka i shtoj, vetëm ta lexoj. Zyra ligjore ma ka sjell këtë shkresë, në të cilën propozimi i Qeverisë është të vazhdohet me 8, por megjithatë në fund kryetari i Kuvendit duhet ta nënshkruajë këtë vendim, i cili, thjeshtë, nuk ka bazë ligjore.

Ky Kuvend megjithatë e merr këtë përsipër, qysh do, si të votojë. Qe një vit kjo çështje ka pritur të zgjidhet, dhe që nga data 16 dhjetor 2014 është kërkuar me shkrim. Do të thotë, sot është dita e fundit, dhe ne në ndërkohë mund t'i humbim 33 milionë, që këtë duhet pas parasysh.

Është kjo një situatë reale. Unë, nëse ju e merrni si vendim, do të konsultohem prapë me zyrën ligjore dhe në të njëjtën kohë do të mundohem të konsultohem edhe me partnerët ndërkombëtarë pasi që është pjesë e zbatimit të Marrëveshjes për përmbushjen e obligimeve për përmbylljen e pavarësisë së Kosovës. Dhe nëse nuk ka pengesa a diçka tjetër, për çmim politik, e nënshkruaj.

Mirëpo, realisht, interpretimi i Zyrës ligjore, edhe një herë po e ritheksoj, si deputet ndoshta e kisha votuar, por si kryetar i Kuvendit nuk më preferohet e as këshillohet që ta nënshkruar diçka që është e jashtëligjshme.

Thjeshtë! Këtu juristë ka mjaft dhe secili mund të ketë interpretim, por ne kemi petk edhe politik.

Thashë dhe po them edhe një herë, votoni ju dhe unë do të kam qëndrim abstenimi...

(Ndërhyrje)

Sa deputetë jemi? 53! Kryetarët e grupeve parlamentare është mirë të thirren deputetë!

Urdhëro, profesor!

MUHAMET MUSTAFA: Ju lutem! Këtë problem e kemi trajtuar edhe në mbledhjen e Komisionit dhe kemi vërejtur një diferencë në interpretimet ligjore nga shërbimi juridik i Qeverisë dhe shërbimi juridik i Kuvendit.

Megjithatë, Komisioni ka vendosur si vijon:

Duke pasur parasysh se me Ligjin i cili ka përfunduar pavarësinë e mbikëqyrur, është e qartë se me atë ligj më nuk ka anëtarë ndërkombëtarë të Bordit. Prandaj, logjikisht, meqë është abroguar neni ku thuhet se ka ndërkombëtarë të Bordit, ne sot mund të zgjedhim 8 anëtarë ndërkombëtarë.

Çështja tjetër, te marrja e vendimeve. Ka mbetur që për marrje të vendimeve duhet të jetë vendim ndërkombëtar. Ka mbetur, dhe teknikisht është harruar të hiqet kur është prur ai ligj, që i ka abrogua shumë ligje.

Prandaj, me hyrjen në fuqi të Ligjit që e sollëm ne, vendimet mund të merren të plotfuqishme dhe ne mund t'i zgjedhim sonte 8 pa kurrfarë problemi dhe ju ftoj që t'i votoni.

KRYETARI: Atëherë, kryetarë të grupeve parlamentare, a mund të sigurojmë së pari kuorum sepse kjo është sikur kur thoshte paraardhësi im me mbarë petulla në ujë, baca Jakup.

Pra, s'kemi kuorum!

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, në bazë edhe të konsultimeve me Administratën, po e bëjmë kështu. Vazhdimi i seancës do të jetë ditën e enjte, pas adresimit të Presidentes. Pra, është vazhdim i seancës, ta keni parasysh.

(Ndërhyrje)

Pastaj, në ndërkohë komunikimi i zyrave ligjore të Qeverisë dhe Kuvendit le të harmonizohen së bashku me të gjithë faktorët relevantë dhe mos ta kemi këtë situatë sikur të sotmen.

Faleminderit për mirëkuptim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*